

UDHËZIM
Nr. 31, datë 18.11.2019

**PËR PROCEDURAT STANDARDE TË APLIKIMIT DHE KRITERET PËR
PËRFITIMIN E FONDEVE NGA BUXHETI I SHTETIT PËR PROGRAMET E
STREHIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 69, pika 2, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e strategjisë së strehimit social 2016–2025”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, afateve dhe kriterëve të aplikimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për përfitimin e fondeve të planifikuara në ligjin vjetor të buxhetit, në programin buxhetor “strehimi”.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqesin aplikimet e tyre çdo vit, me qëllim përfshirjen e kërkesave të tyre për mbështetje nga fondet buxhetore në projektbuxhetin afatmesëm. Aplikimi, për t’u përfshirë në projektbuxhetin afatmesëm, bëhet brenda afateve të parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe shoqërohet me të dhënat e tabelës nr. 1. Ky aplikim përmban kërkesat buxhetore për realizimin e një apo disa programeve të strehimit social, sipas nenit 11, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” dhe/ose për mbështetje me instrumente financiare, sipas kreut V dhe neneve 42, 46, 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si edhe për mbështetje për realizimin e formave të bashkëpunimit dhe partneritetit shtet–privat.

Tabela nr. 1

Kategoria 1 ¹				
Titulli i projektit ²				
Lloji i produktit	Familje të strehuara			
Njësia matëse	Numër			
	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia e produktit (nr. familje)				
Kostoja totale e projektit (në mijë lek)				
Buxheti i bashkisë				
Financim nga donatorë				
Kërkesa për mbështetje buxhetore				

3. Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent bëhet brenda muajit janar të çdo viti, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Ky aplikim shoqërohet me të dhënat sipas tabelës nr. 2.

Tabela nr. 2 **Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit**

¹ Kategoria: 1. Shpenzime korrente; 2. Shpenzime kapitale (230 ose 231).

² Vendoset titulli i projektit për të cilin aplikohet ose i instrumentit financiar, p.sh., “Projekti i përmirësimit të banesave” (shpenzime kapitale) ose “Subvencionimi i qirasë” (shpenzime korrente).

Njësia e vetëqeverisjes vendore

Nr.	Lloji i informacionit	PO	JO	Pjesërisht	Sqarime/ komente/informacion
1	Disponon në pronësi banesa sociale me qira				Numri i banesave sociale që disponon bashkia
2	Zotëron fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg				Sasia e fondeve që do të vërë në dispozicion
3	Ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm se sa subvencionimi i qirave				Vlera mesatare e shitblerjes së banesave në treg, sipas strukturave të apartamenteve
4	Ka në dispozicion të programit banesa në pronësi të pronarëve socialë				Numër ose sqarime të tjera
5	Ka ngritur strukturën përgjegjëse për strehimin				
6	Ka hartuar programin 5-vjeçar për strehimin				
7	Ka vlerësuar nevojat për strehim				
8	Ka dërguar informacionin vjetor, sipas shkronjës “dh”, të pikës 2 të nenit 73, të ligjit nr. 22/2018				
9	Fonde për subvencionimin e qirasë së vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore				
10	Popullsia e regjistruar më 1 janar të vitit të mëparshëm				
11	Të ardhurat e veta të bashkisë të vitit të mëparshëm				

4. Të dhënat sipas pikave 1, 2, 3, 4, 9, 10 e 11, të tabelës nr. 2 të këtij udhëzimi, janë informuese dhe shërbejnë për të argumentuar llojin e programit për të cilin aplikon njësia e vetëqeverisjes vendore dhe përqindjen e financimit. Të dhënat që dalin nga raporti i pikës 11 me pikën 10 të tabelës, njësia e vetëqeverisjes vendore i konfirmon pranë strukturës përgjegjëse për financat vendore në ministrinë përgjegjëse për financat.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk plotësojnë kushtet, sipas pikave 5, 6, 7 e 8 të tabelës nr. 2, të këtij udhëzimi skualifikohen nga përfitimi i fondeve për ndërtimin e banesave sociale ose të banesave me kosto të ulët.

6. Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent respekton edhe rregullat si më poshtë:

a) për të përfituar mbështetje për subvencionimin e qirasë për banesa sociale në tregun e lirë, njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë brenda dy javëve të para të muajit janar. Format i aplikimit është sipas VKM-së nr. 459, datë 3.7.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”;

b) për të përfituar grant të menjëhershëm, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si rregull duhet të aplikojnë sipas afateve të përcaktuara në germën “a” të kësaj pike, me përjashtim të rasteve kur situatat e krijuara për përfitimin e grantit të menjëhershëm janë krijuar më pas dhe nuk janë parashikuar në kohë;

c) për të përfituar fonde investimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t'i përgjigjen thirrjes që shpall ministria përgjegjëse për strehimin, ku përcaktohen afatet kohore për dorëzimin e projekteve, dokumentacioni që duhet të dorëzojë njësia e vetëqeverisjes vendore, informacioni që duhet të shoqërojë aplikimin, kriteret skualifikuese dhe sistemi i pikëzimit për kualifikimin e fituesve të garës.

7. Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, janë në varësi të të ardhurave për frymë, sipas tabelës nr. 3, dhe në raport të drejtë me numrin e aplikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përkundrejt totalit të aplikimeve në shkallë vendi.

Tabela nr. 3

Nr.	Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (/000 lek)	Forma e financimit Grant i kushtëzuar
1	me të ulëta se 2,000	deri 100%
2	2,001–4,000	deri 80%
3	4,001–6,000	deri 70%
4	6,001–8,000	deri 60%
5	mbi 8,001	deri 50%

8. Shqyrtimi, vlerësimi dhe miratimi i projektpropozimeve, sipas pikës 6, germa “c”, të këtij udhëzimi bëhet nga një komision i ngritur në ministrinë përgjegjëse për strehimin, i përbërë nga:

- a) zëvendësministri që mbulon çështjet e strehimit, kryetar;
- b) drejtori i përgjithshëm që mbulon çështjet e strehimit në ministrinë përgjegjëse për strehimin anëtar;
- c) drejtori i përgjithshëm që mbulon çështjet e buxhetit në ministrinë përgjegjëse për strehimin anëtar;
- ç) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale anëtar;
- d) një përfaqësues i shoqatave që përfaqësojnë autoritetet vendore anëtar;
- dh) një përfaqësues i shoqatave që mbrojnë interesat e grupeve të veçanta, si minoriteti rom dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, gra të dhunuara etj., mund të ftohet për të marrë pjesë në komision, pa të drejtë vote.

9. Ministria përgjegjëse për strehimin i drejtohet çdo vit, me shkrim, shoqatave të përmendura në germën “d” dhe “dh”, të pikës 8, të këtij udhëzimi për të propozuar përfaqësuesit e tyre. Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqatave, sipas këtyre germave, realizohet nga ministria përgjegjëse për strehimin, në bazë rotacioni.

10. Komisioni ushtron veprimtarinë e vet, në përputhje me ligjin në fuqi për organet kolegjiale dhe miraton vendimet e veta me shumicë të thjeshtë.

11. Struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin ushtron kompetencat e sekretariatit të komisionit të ngritur, sipas pikave 8 dhe 9 të këtij udhëzimi. Struktura përgjegjëse ngarkon shprehimisht një punonjës të vetin që të ushtrojë detyrën e sekretarit të komisionit, si dhe një zëvendësues të tij/saj, në rastet e pamundësisë së ushtrimit të funksionit nga i pari.

12. Me përfundimin e afatit të aplikimit, struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin përpunon dokumentacionin e aplikimit të ardhur nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore dhe, brenda 45 ditëve pune, përgatit një raport përmbledhës, përfshirë një vlerësim paraprak. Në rastet kur numri i aplikimeve është i madh, afati i përfundimit të raportit mund të shtyhet edhe 15 ditë të tjera pune. Raporti përmbledhës përmban:

- a) përshkrimin e projekteve të paraqitura;
- b) statistika mbi llojin e projekteve të propozuara, numrin dhe kategoritë e përfituesve dhe çdo të dhënë tjetër që ka shërbyer për të bërë vlerësimin paraprak;
- c) problemet e ndeshura;
- ç) mënyrën e aplikimit të sistemit të pikëzimit për përgatitjen e renditjes paraprake të propozimeve;
- d) projektet e skualifikuara, nëse ka, dhe arsyet e skualifikimit të tyre;
- dh) çdo informacion tjetër të nevojshëm.

13. Komisionit i paraqitet raporti përmbledhës, i hartuar sipas pikës 12 të këtij udhëzimi dhe aplikimet e plota, të paktën 5 ditë pune përpara datës së mbledhjes.

14. Komisioni ka për detyrë të:

- a) njihet me raportin e përgatitur, sipas pikës 12 të këtij udhëzimi dhe aplikimet e plota të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- b) miratohet projektet fituese që do të financohen nga buxheti i shtetit me vendim, i cili shoqërohet me tabelën përfundimtare të ndarjes së fondeve;
- c) të dokumentojë me procesverbal mbledhjen.

15. Në përcaktimin e fituesve të projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit në një vit buxhetor, Komisioni mund të klasifikojë një numër të kufizuar fituesish ose mund të klasifikojë të gjitha projektet si fituese, kur ndryshimet mes cilësisë, përmbajtjes, qëllimit, prioritetit a kriterëve të tjera nuk janë tepër të dallueshme.

16. Në rastin kur fondet e akorduara në një vit buxhetor janë të pamjaftueshme për të mbështetur me financim apo bashkëfinancim, kërkesat e njësisë të vetëqeverisjes vendore, struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin i propozon Komisionit, ndarjen e financimit në vite, por në jo më shumë se në dy vite, përveç rastit të projekteve madhore, të cilat miratohen me procedura të veçanta nga ministri përgjegjës për strehimin.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj